



RIVER
CLEANUP
ALBANIA

RIVER CLEANUP ALBANIA

Si nisi, kush jemi dhe ku duam të mbërrijmë?
How did it start, who are we and what do we want to reach?





RIVER CLEAN UPALBANIA

Si nisi, kush jemi dhe ku duam të mbërrijmë?

How did it start, who are we and what do we want to reach?



Biolvealbaniangroup nisi në vitin 2018 me vullnetarë gjimnazistë, studentë, mësues e pedagogë nga qyteti bregdetar i Durrësit, duke u bërë pjesë e projektit Interreg Med ACT4LITTER Marine Litter Watch Month, një projekt për të pastruar e studiuar mikroplastikat për pjesën e bregdetit shqiptar; projekt që u referua si leksion i hapur në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës me temë: “Monitorimi i mikroplastikave detare në plazhet e gjireve të Durrësit dhe Lalëzit”, si dhe u përmbyll me një artikull shkencor: “Marine litter on the Albanian coastline: Baseline information for improved management” në revistën “Ocean and Coastal Management” të grupit Elsevier.



RIVER CLEANUP ALBANIA

Si nisi, kush jemi dhe ku duam të mbërrijmë?

Kuratorë: Laura Gjyli, Jerina Kolutari, Brisejda Lala

Fotografia: Elvin Shytaj, Ines Goovaevarts, Endri Tahiri, Mrinë Gorenca / *Europe House, and EU-funded project in Albania*
Xhafer Rakiplari dhe studentët e UAMD -së dhe gjimnazistët e shkollës Ibrahim Kodra

Përshtati në anglisht: Edvin Cami

ISBN 978-9928-357-56-4

Iniciatorët e lëvizjes **RIVERCLEANUPALBANIA nga Brukseli:**
Lideri i RIVERCLEANUP WORLD Thomas de Groot,
përfaqësues i RIVERCLEANUPALBANIA nga Brukseli Kevin De Backer

Shtysa për t’u marrë me mbetjet plastike u mor nga projekti ndërkombëtar IPA DeFishGear (2013-2016), i cili ishte i pari që merrte në shqyrtim mbetjet plastike sipas metodologjisë së unifikuar për gjithë shtetet që lagen nga deti Adriatik.

Biolovealbaniangroup nisi në vitin 2018 me vullnetarë gjimnazistë, studentë, mësues e pedagogë nga qyteti bregdetar i Durrësit, duke u bërë pjesë e projektit Interreg Med ACT4LITTER Marine Litter Watch Month, një projekt për të pastruar e studiuar mikroplastikat për pjesën e bregdetit shqiptar, projekt që u referua si leksion i hapur në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës me temë: “Monitorimi i mikroplastikave detare në plazhet e gjireve të Durrësit dhe Lalëzit”, si dhe u përmbyll me një artikull shkencor: “Marine litter on the Albanian coastline: Baseline information for improved management” në revistën “Ocean and Coastal Management” të grupit Elsevier.

Shtysa për t’u marrë me mbetjet plastike u mor nga projekti ndërkombëtar IPA DeFishGear (2013-2016), i cili ishte i pari që merrte në shqyrtim mbetjet plastike sipas metodologjisë së unifikuar për gjithë shtetet që lagen nga deti Adriatik.

Pas përvojës së parë për mbrojtjen e mjedisit, në vitin 2019 ekipi Biolvealbaniangroup, si përfaqësues e shkollës Ibrahim Kodra, arriti të fitonte çmimin e dytë midis 110 shkollave të mesme pjesëmarrëse, në Olimpiadën e Parë Ndërkombëtare të Katastrofave Natyrore dhe Teknologjike “Better knowledge against disasters”; konkurs ndërkombëtar, organizuar në kuadër të projektit BeSafeNet, i zbatuar nga Mbrojtja Civile e Qipros / Ministria e Brendshme, dhe i sponsorizuar nga Marrëveshja Evropiane dhe Mesdhetare e Rreziqeve të Mëdha (EUR-OPA), duke u paraqitur denjësisht në Këshillin e Europës në Strasburg ([BeSafeNet Olympiad Award Ceremony: “Better knowledge against disasters”](#)).



Nisur nga sukcesi që pati puna me rininë, në vitin 2019 vazhduan me pastrimin dhe studimin e bregdetit tonë duke u ndalur tek Gjiri i Rodonit, pranë kishës së Shna Ndout, në Kepin e Rodonit, ndryshe quajtur Kepi i Skënderbeut.

Durrësi përjetoi dy periudha të vështira: tërmetin e 26 nëntorit dhe pandeminë Covid-19. Ndaj dhe ky ekip vullnetar (me gjimnazistë, studentë, mësues e pedagogë) u përpoq të jepte mbështetjen e tij modeste në ndihmë të njerëzve në nevojë në qarkun Durrës, duke bashkëpunuar me “Lions Club International” dhe “Fundjavë Ndryshe”.

Me heqjen e kufizimeve të mbylljes nga pandemia, ekipi vullnetar filloi të organizohej për të vazhduar misionin e tij në ndihmë të komunitetit: “Pastrimin e brigjeve të detit dhe lumenjve”, tani edhe më të vendosur për të krijuar një organizatë jofitimprurëse nën emrin “Youth for NatureAlb” me vullnetarë që kanë si pikësynim mbrojtjen dhe shpëtimin e Tokës, pasi menduan se Covid-19 erdhi si rrjedhojë e prishjes të ekuilibrit Natyrë-Njeri.

@RiverCleanupAlbania mori emrin si një nismë vijuese e @RiverCleanup, e cila ndërmerr aksione në 45 vende të globit për pastrimin e lumenjve me vullnetarë, që aspirojnë mbrojtjen dhe shpëtimin e Tokës, të cilët njihen

si “River Warriors - Luftëtarë të Lumenjve”, nën moton “Clean locally, celebrate globally - Pastro lokalisht, festo globalisht”. Shikoni filmin tonë në vitin 2019: <https://vimeo.com/396248996> dhe në vitin 2020: <https://vimeo.com/434527197> për të ndjerë energjinë e lëvizjes sonë.

Me River-cleanup.org kontaktuam për herë të parë përmes Instagramit më 5 qershor, duke kërkuar një mbështetje për të na ndihmuar në pastrimin e lumenjve të qytetit tonë bregdetar, Durrësit: lumenjve Ishëm dhe Erzen.

-Projekti i parë nisi me aktivitetin e 7 qershor, 2020, në bregun e lumit Erzen, fshati Katundi i Ri, ku e nisëm me 5 vullnetarë ose River Warriors, siç na quajnë organizata jofitimprurëse “River-cleanup.org” me qendër në Bruksel.

-Aktiviteti i dytë më 24 qershor, vijoi në grykëderdhjen e lumit Erzen me 15 River Warriors, ku na mbështeti Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Durrës.

-Aktiviteti i tretë më 8 korrik vijoi në grykëderdhjen e lumit Ishëm, (bregu nga ana e bashkisë Durrës), me 17 River Warriors, ku na u bashkuan banorë të zonës, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Durrës dhe mbetjet e grumbulluara nga lumi u dërguan në landfillin e Sharrës, Tiranë, me mbështetjen e kompanisë private “Clean-City.al”, e cila operon në Durrës. Kontrolloni videot për të zbuluar situatën në grykëderdhjen e Ishëm: <https://vimeo.com/449468655>, <https://www.instagram.com/p/CN0qtQKBmOE/>

-Më datë 2 gusht realizuam aktivitetin e katërt në grykëderdhjen e lumit Ishëm, (bregu nga ana e bashkisë Kurbin), në bashkëpunim me River-cleanup.org, me 77 River Warriors, kryesisht studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe gjimnazistë të shkollës Ibrahim Kodra, ku u bashkuan edhe banorët e zonës, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Durrës, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Lezhë, kompania private “Clean-City.al”, Komuna Ishëm, Bashkia Kurbin, si dhe Bashkia Durrës me Drejtorinë e Komunales, si dhe shoqata e Ishmit. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CEERu7aAsWj/>

-Më datë 28 gusht realizuam aktivitetin e pestë, në lumin Seman aty ku bashkohet me Gjanicën me 20 River Warriors së bashku me banorë të zonës, Bashkia Durrës me Drejtorinë e Komunales, dhe kompania private “Eden Tours & Travel”, e cila mbuloi me 70% transportin e vullnetarëve.

River-cleanup.org, veçanërisht e interesuar për lumin më të ndotur në Evropë, lumin Ishëm, ku në detin Adriatik përfundojnë 733,000 kg mbetje/vit, kryesisht plastikë, në bashkëpunim me lëvizjen @RiverCleanupAlbania, vijoi monitorimin, sensibilizimin dhe pastrimin në disa hotspote të degëve të lumit Ishëm me projektin vullnetar “River Cleanup Ishëm Project, 2020”.



Grykëderdhja e lumit Ishëm është brenda zonës së mbrojtur detare/bregdetare Patok-Fushëkuqe-Ishëm me një sipërfaqe prej 5,001 ha nën statusin e mbrojtjes: Rezervat Natyror i Menaxhuar / Park Natyror IUCN, kategoria IV dhe Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) si habitat për shpendët migratore (AL006) (AKZM/UNDP, 2015; Miho et al., 2013). Për më tepër Rezervati Natyror i Kepit Rodon ndodhet brenda Zonës së Peisazhit të Mbrojtur / Peisazhit të Kepit të Rodonit-Gjiri i Lalzit-Pylli i Ishmit me një sipërfaqe prej 2.500 ha dhe i klasifikuar në kategorinë V, IUCN (Miho et al., 2013; Kashta, 2010).

-Më datë 19 shtator realizuam aktivitetin e gjashtë në përroin e Lanës, në Lanabregas dhe Urën e Astirit, me 32 River Warriors kryesisht gjimnazistë dhe studentë nga Durrësi, së bashku me banorë të zonës dhe kompaninë private “Eden Tours & Travel”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CFffYHgHeQT/>

-Më datë 3 tetor realizuam aktivitetin e shtatë në përroin e Lanës, në Mëzez, me 18 River Warriors së bashku me banorë të zonës dhe kompania private “Eden Tours & Travel”.

-Aktiviteti i tetë më 10 tetor vijoi në lumin e Tiranës në Paskuqan, me 23 River Warriors, së bashku me banorë të zonës, Drejtorinë e Politikave dhe Edukimit Mjedisor, Bashkia Tiranë, si dhe kompania private “Eden Tours & Travel”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CGQXQyUnLrH/>

-Aktiviteti i nëntë më 24 tetor vijoi tek përroi e Limuthit, në Urën e Limuthit dhe fshatin Bërxullë, me 31 River Warriors, ku na u bashkuan edhe banorët e zonës, Bashkia Vorë, si dhe kompania private “Eden Tours & Travel”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CG-1KXCHtaf/>

-Më datë 31 tetor realizuam aktivitetin e dhjetë tek lumi i Gjolës, në Urën e Gjolës, me 44 River Warriors, ku u bashkuan edhe banorët e zonës, Bashkia

Krujë dhe Bashkia Vorë, si dhe kompania private “Eden Tours & Travel”, si dhe organizata joqeveritare enforcesustainability.org, Albania. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CHFjCiunb1M/>

-Më datë 21 nëntor realizuam aktivitetin e njëmbëdhjetë “Bishtat e Cigareve” tek Plazhi i madh Durrësit, ku morën pjesë 21 River Warriors të moshave 5-11 vjeç, parashkollorë dhe nxënës të qytetit të Durrësit, kryesisht nga shkolla “Ibrahim Kodra”. Ata mblodhën 1722 bishta cigaresh në një orë. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CH-wYFXnHTC/>

-Më datë 20 mars realizuam aktivitetin e dymbëdhjetë tek lumi i Gjolës “Mbjellja e 300 pemëve tek Ura e Gjolës në të dy anët e lumit”, kryesisht plep dhe eukalipt për të penguar erozionin, fidanë të financuar nga zyra noteriale “Petani Law-Firm”, aksion ku morën pjesë 31 River Warriors nga shkolla “Ibrahim Kodra”, studentë dhe pedagogë nga UAMD dhe FShN, UT, aktivistë natyre, bashku me banorë të zonës, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Durrës dhe Bashkia Krujë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Znj. Milva Ekonomi, dhe deputetë të zonës, si dhe kompania private “Eden Tours & Travel”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CMvPgDRhieB/>

-Më datë 10 prill, realizuam aktivitetin e trembëdhjetë tek lumi i Tërkuzës, Ura e Vjetër e Rinasit, aksion ku morën pjesë 36 River Warriors nga shkolla “Ibrahim Kodra”, studentë dhe pedagogë nga UAMD dhe FShN, UT, aktivistë natyre, banorë të zonës, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Durrës dhe Bashkia Krujë, si dhe kompania private e riciklimit të plastikës B.I.A.P, e cila pranoi bashkëpunimin me ne për riciklimin e mbetjeve plastike B.I.A.P, kompania private “Eden Tours & Travel”, si dhe organizata joqeveritare Ceapal Albania. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CNvQTJ8hxqy/>

-Më datë datë 1 maj, realizuam aktivitetin e katërbëdhjetë tek burimi i lumit Ishëm, liqeni i Bovillës, ku realizuam ngjitjen e 1000 m lartësi të malit të Gramtit mbi nivelin e detit, me 22 River Warriors më të trajnuar të lëvizjes

RiverCleanupAlbania, së bashku me Agjencinë e Zonave të Mbrojtura, Durrës, nën përvojën e çertifikuar të kompanisë private “Giuda Albania”, e cila rimbursoi me 30% udhëtimin e vullnetarëve. Shikoni burimin e lumit Ishëm: <https://www.instagram.com/p/COdBfVUHBU8/>



-Aktiviteti i pesëmbëdhjetë më 14 maj, i cili shënon ardhjen e përfaqësueve të River-Cleanup.org në Shqipëri, z. Kevin De Backer dhe znj. Ines Goovaerts dhe takimin zyrtar me Rektoratin e UAMD-së, vijoi me një sesion inspirimi dhe aktivizimi të 120 River Warriors, nxënës të shkollës Ibrahim Kodra, moshë 6-11 vjeç, duke realizuar një aksion pastrimi 10 minutësh pranë mjediseve jashtë shkollës Ibrahim Kodra, ku mori pjesë media më e mirë në Shqipëri, Top Chanel, nën mbikëqyerjen e Drejtorisë së Policisë, Qarku Durrës. Shikoni videon: https://www.youtube.com/watch?v=LI_bSRxNSmU

-Aktiviteti i gjashtëmbëdhjetë më 15 maj, i cila shënon ardhjen e përfaqësueve të River-Cleanup.org në Shqipëri, z. Kevin De Backer dhe znj. Ines Goovaerts, vijoi me aksion të madh të grykëderdhjes së lumit Ishëm (bregu nga ana e bashkisë Durrës), me 200 River Warriors, kryesisht gjimnazistë të shkollave “Ibrahim Kodra” dhe “Leonik Tomeo”, si dhe studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, me pjesëmarrjen e aktivistëve të natyrës dhe banorëve, Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, Durrës, nën mbështetjen e prefektit të Qarkut Durrës, z. Roland Nasto, si dhe kompanive private të riciklimit të plastikës B.I.A.P dhe Flamur Lahi, që na siguruan përkatësisht thasët dhe transportin falas të mbi 600 thasëve të mbetjeve të grumbulluara nga vullnetarët; kompanisë private “Eco-Riciklimi, Medical Waste Services”, e cila siguroi transportin dhe djegien në krematorium të tre kontenerëve me mbetjeve më të rrezikshme, ato spitalore; kompanisë private “Eden Tours & Travel”, që mbuloi me 70% transportin e vullnetarëve, si dhe organizatës enforcesustainability.org, Albania dhe shoqatës “Vullnetarët për një atdhe të pastër”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CPEF4wKHgKJ/>



-Aktiviteti i shtatëmbëdhjetë më 5 qershor, që përkon me 1-Vjetorin e RiverCleanupAlbania, u krye në Sektorin Rinia, plazhin me një pyll plot pisha. Ky aksion ishte mesazh për Ditën Botërore të Mjedisit (5 qershor) dhe Ditën Botërore të Lumenjve (6 qershori, sipas [River-Cleanup.org](https://www.river-cleanup.org/)), që Dita e Oqeanëve (8 Qershori) të gjejë lumenj dhe dete më të pastra. Në këtë aksion morën pjesë 61 River Warriors, kryesisht gjimnazistë të shkollës Ibrahim Kodra dhe studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, me pjesëmarrjen e Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, Durrës, nën mbështetjen e Prefektit të Qarkut Durrës, z. Roland Nasto, si dhe Bashkinë Durrës me Drejtorinë e Komunales, nën drejtimin e Rektoratit të UAMD-së, Drejtorit të Administratës dhe Shërbimeve Akademike, Dr. Xhafer Rakiplari. Ky aksion u suportua nga Delegacioni i Bashkimit Europian dhe Europa House për Shqipërinë, në Ditën Botërore të Mjedisit, 5 Qershor 2021 nën kujdesin e ambasadorit të Bashkimit Europian për Shqipërinë, z. Luigi Soreca. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CQBCWGXn1hP/>



-RiverCleanupAlbania i regjistron dhe klasifikon artikujt e makro-mbetjeve (>2.5 cm) lumore të mbledhura nga vullnetarët sipas Master Listës së Kategorive të Artikujve të mbetjeve, në 8 (tetë) grupe kryesore të llojeve të materialeve: si plastikë, gomë, roba/tekstile, letër/karton, dru i përpunuar/punuar, metal, qelqi/qeramikë, dhe artikuj të paidentifikuar dhe/ose kimikate, si dhe në 160 emra artikujsh/sendesh (Galgani et al. 2013), duke bërë të mundur jo vetëm studimin shkencor të makroplastikës lumore (González et al. 2016), por edhe riciklimin e mbetjeve të mbledhura nga vullnetarët lehtësisht të aksesueshme nga kompanitë e riciklimit.

-Brenda një viti lëvizja River Cleanup Albania, ka kryer 12 aksione pastrimi dhe sensibilizimi përgjatë lumit Ishëm, si dhe ka mbledhur nga 950 duar të River Warriors tanë, 6700 kg mbetje të ngurtë, ku mbi 80% e tyre rezultojnë polimer artificial (plastikë). Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CTdBDWMDnS3/>

-Mbi 90% e sendeve të mbledhura janë plastikë, ku kryesisht në grykëderdhje janë gjetur G8 (Shishe pijesh > 0,5 l), G7 (Shishe pijesh ≤ 0,5 l), G9 (Shishe dhe kontejnerë detergjentësh) përkatësisht 34%, 31% dhe 10% (<https://www.river-cleanup.org/en/ishem>, <https://www.instagram.com/rivercleanupalbania/>).



Brenda një viti lëvizja RiverCleanupAlbania ka shkruar 4 projekte dhe ka fituar 2 çmime.

-Një projekt si bashkëpunim të programit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, midis universiteve koordinatorë UAMD dhe BOKU, me bashkëpunëtorë UT dhe UBT me titull: “Matjet e transportit makroplastik në lumin Ishëm, lumi më i ndotur në Evropë”, sipas metodologjisë [Liedermann](#)

[et al. 2018](#). (Në pritje për vlerësim).

-Në konkursin e organizuar nga @Plastichunt më 27 Gusht 2020, River Warriors të @RiverCleanupalbania me grupin e tyre “Plastic heist”, u vlerësuan në 10 skuadrat më të mira, duke u renditur në vendin e pestë nga 183 skuadra prej 65 shteteve në gjithë botën. Përveç kuizit grupi “Plastic heist” konkuroi edhe me skulpturën “Coronavirus”, e ndërtuar mbetje plastmasi të artistit Ardian Tragaj, themeluesit të kompanisë private “Clean-City.al”, si dhe me fotot e artistit Elvin Shytaj. Shiko instagramin.

-Një projekt i fituar në Erasmus Plus nga organizata RiverCleanup.org, si bashkëpunim me lëvizjen RiverCleanupAlbania, për të sjellë studentë të huaj pranë lumit më të ndotur në Evropë dhe për të shkëmbyer eksperiencën me vullnetarët e lëvizjes RiverCleanupAlbania.

-Një projekt i fituar nga shkolla e mesme “Ibrahim Kodra” më 19 Maj 2021, me çmimim e parë në konkursin ndërkombëtar për vendet e rajonit Lindor në kuadër të thirrjes “Qytetarë të rinj aktivë për zhvillim të qëndrueshëm në iniciativën e Evropës Qendrore (CEI) dhe Zonat e Adriatikut dhe Jonit (All)” me titull “Mbetje më pak të rrezikshme në qytet, më shumë ushqim dhe ujë të pastër në tryezat e të varfërve dhe më shumë mënyra për të luftuar varfërinë”. Ky projekt pati idenë e River Warrior Alina Xhani dhe shokëve të saj, nën drejtimin e mësueses së tyre, Dr. Merlina Koseni. Kontrolloni linkun: <https://www.cei.int/news/9061/winners-of-call-for-ideas-for-sustainable-development-announced>

-Një projekt-ide e hedhur në letër për transformimin e lumit të Gjolës deri në grykëderdhjen e Ishmit, si vend-depozita e plastikës, të cilin duam ta aplikojmë për ta kthyer plastikën e mbledhur nga vullnetarët në diçka të dobishme për komunitetin dhe natyrën: 1) në kosha për banorët, 2) shtrimin e rrugëve,

përfshirë edhe rrugën e vështirë Likmetaj-Grykëderdhje e Ishmit, 3) mbjelljen e pemëve anash brigjeve të lumit, duke i mbrojtur nga erozioni, për të evituar përmytjet, 4) stola për kthimin e zonave pranë lumit si parqe për të pushuar banorët dhe vizitorët; 6) largimin e trugjeve të pemëve të vdekura në dy anët e lumit; 5) ndihmë për më shumë ushqim dhe ujë të pastër në familjet e heronjve të heshtur të pastrimit dhe riciklimit të mbetjes urbane plastike të qyteteve tona. Kjo do të realizohet si bashkëpunim përmes pastrimit nga duart e vullnetarëve dhe teknologjisë, edukimit të shkollave dhe universiteteve si dhe transformimit nga ana e kompanive private dhe qeverisë.



-Sipas TheOceanCleanup dhe River-Cleanup.org, lumi Ishëm, është lumi më i ndotur në Evropë me 733,000 kg mbetje/vit, që përfundojnë në detin Adriatik!!! Ajo që duam të bëjmë është t'i kthejmë dinjitetin lumit Ishëm siç ka emrin, “lumi i hijshëm”, të mbrojmë bukurinë e Kepit të Rodonit që ndotet nga ky lumë, dhe kjo realizohet në bashkëpunim me përvojën e Rivercleanup, përmes:

1. **Pastrimit të lumit me duart e njerëzve dhe me teknologjinë e fundit;**
2. **Edukimit të fëmijëve dhe të rinjve në shkolla dhe universitete;**
3. **Transformimin nga ana e kompanive dhe e qeverisë.**

-Kjo përvojë e suksesshme me lumin Ishëm të shtrihet në lumenjtë e tjerë, si Erzen, Shkumbin, Seman dhe Bunë.

Bëhuni pjesë e zgjidhjes dhe jo pjesë e problemit.

Lëvizja @RiverCleanupAlbania ka gjithë kapacitetet njerëzore, që nën përvojën e River-Cleanup.org, Bruksel, të japë një kontribut të prekshëm në komunitet, duke lidhur pastrim-edukimin-transform-shkencë për mbrojtjen e natyrës shqiptare, kryesisht mbrotjen e lumenjve nga plastika, ku 8 miliard kg plastikë përfundon çdo vit në oqeanë dhe 80% e saj vjen nga lumenjtë.

Plani për 2021: Ne do të pastrojmë me duart e njerëzve dhe do të testojmë teknologjinë në lumin e Gjolës, ne do të edukojmë rininë në 10 shkolla, për ta mbledhur plastikën dhe ricikluar atë, me qëllim transformimin e lumin Ishëm në një lum të pastër.

-Ne duam ndihmë nga kompanitë private, të na mbështetin gjatë aksioneve të pastrimit dhe sensibilizimit me fëmijët, gjimnazistët dhe studentët e trajnuar në bashkëpunim me River-Cleanup.org, Bruksel, me shërbime dhe financiarisht, për pastrimin e lumit më të ndotur në Evropë, lumit Ishëm.

-Ne duam ndihmë nga qeveria shqiptare. Duam leje për zhvillimin e teknologjisë dhe të na mbështesë gjatë aksioneve të pastrimit (me transport/mjete/...) dhe sensibilizimit, njohjen e punës vullnetare zyrtarisht si punë komunitare në kurrikulat e gjimnazistëve dhe studentëve të trajnuar në bashkëpunim me River-Cleanup.org, Bruksel, si dhe punën vullnetare të kompanive private, që na mbështetin në aksionet e RiverCleanupAlbania për pastrimin e lumit Ishëm.



Në vitin e dytë lëvizja @RiverCleanupAlbania ka vijuar me aksionet:

-Aksioni i tetëmbëdhjetë u realizua më 5 qershor në Urën e Rinasit, pranë lumit të Tiranës nga Bashkia Vorë. Sipas specialistit Ing. Armand Kurti nga Bashkia Vorë dhe River Warrior të RiverCleanupAlbania, nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë Vorë, në aksion morën pjesë 285 River Warriors, prej tyre 196 nxënës të shkollave të mesme të klasave XI, Drejtoria e Shërbimit me 75 punonjës, 9 punonjës nga Administrata dhe 4 punonjës nga Policia Bashkiake. U mbledhën 900 kg mbetje, të cilat u tërhoqën nga 4 kamionë të kompanisë së pastrimit Fusha SHPK, të cilat u dërguan në landfillin e Sharrës.

-Aksioni i nëntëmbëdhjetë u realizua më 13 korrik në Kepin e Rodonit, pranë Kalasë së Skënderbeut. Në aksion morën pjesë 13 River Warriors, kryesisht studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, skautistë nga Franca, specialistë të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, Durrës, nën udhëheqjen e Përgjegjëses së Departamentit të Letërsisë, Dr. Marisa Kërbizi. Ky aksion u suportua nga Rektorati i UAMD-së.

-Më datë 31 korrik, realizuam aksionin e njëzet tek Ura e Rinasit, zona administrative Bërxullë, Bashkia Vorë. Qëllimi ishte pastrimi i pemëve nga plastika dhe heqja e trungjeve të pemëve të vdekuara, si depozitë e plastikës që vijnë nga lumi. Në aksion morën pjesë 23 River Warriors, studentë dhe pedagogë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, gjimnazistë të shkollës “Ibrahim Kodra”, aktivistë natyre, Agjencia së Zonave të Mbrojtura, Durrës; ku nën mbështetjen e Prefektit të Tiranës, Z. Mersin Murati, i cili mobilizoi administratorin Bërxullë, na bashkoi me 8 punonjës të Bashkisë Vorë, të cilët prenë me sharrë trungjet e pemëve të vdekura, zhvendosën disa prej tyre nga vendi, por puna nuk përfundoi, pasi duheshin mjete të rënda (fadromë), që mund të largoheshin trungjet dhe pemët e gjalla të pastroheshin plotësisht nga plastika. Aksioni u suportua nga River-Cleanup.org, Bruksel, si dhe nga kompanitë private “Iliad_Hotel”, që suportoi udhëtimin e vullnetarëve me çmim të reduktuar nga kompania private “Eden Tours & Travel”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CSICiInC33w/>

-Aksioni i njëzet e një u realizua më 4-5 gusht në Urën e Rinasit, përgjatë rrugës nacionale të bregut të lumit Ishëm dhe Urës së Rinasit nga Bashkia Vorë. Sipas specialistit Ing. Armand Kurti nga Bashkia Vorë dhe River Warrior të RiverCleanupAlbania prej 4 aksionesh, nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë Vorë, në aksion morën pjesë 46 River Warriors, prej tyre 40 punëtorë të pastrim-gjelbërimit nga bashkia, 2 policë nga bashkia, një kamionçinë, 2 specialistë. U mbledhën në 16 orë pune 2,900 kg mbetje e ngurtë, kryesisht plastikë, të cilat u dërguan në landfillin e Sharrës.

-Më datë 16 gusht, realizuam aksionin e njëzet e dy tek plazhi Shën-Pjetër, zonë e mbrojtur në Gjirin i Lalëzit pranë Kepit i Rodonit, simboli i RiverCleanupAlbania. Në këtë aksion morën pjesë 36 River Warriors, kryesisht studentë të UAMD-së dhe gjimnazistë të shkollës “Ibrahim Kodra”, por edhe studentë të FShN, UT e FShMT, UM, aktivistë natyre, mësues e pedagogë, specialistë të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, Durrës, punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Komunale, Bashkia Durrës, që dërguan mbetjet e grumbulluara në landfillin e Sharrës, si dhe pushues pranë plazhit. Aksioni u suportua nga River-Cleanup.org, Bruksel, si dhe nga kompanitë private “Iliad_Hotel”, që suportoi udhëtimin e vullnetarëve me çmim të reduktuar nga kompania private “Eden Tours & Travel”. Shikoni videon: <https://www.instagram.com/p/CTAPseCD00m/>

Deri tani janë zhvilluar nga lëvizja RiverCleanupAlbania, 16 aksione pastrimi dhe sensibilizmi përgjatë lumit Ishëm, si dhe ka mbledhur nga 1050 duar të River Warriors tanë rreth 9,000 kg mbetje të ngurtë, ku mbi 80% e tyre rezultojnë polimer artificial (plastikë).

Me nderime,

Lëvizja vullnetare RiverCleanupAlbania

Kuratorë: Laura Gjyli, Jerina Kolutari, Brisejda Lala

Fotografia: Elvin Shytaj, Ines Goovaerts, Endri Tahiri, Mrinë Godanca, studentët e UAMD-së dhe gjimnazistët e shkollës “Ibrahim Kodra”

Iniciatorët dhe mbështetësit e lëvizjes RiverCleanupAlbania nga Brukseli:

Përfaqësuesi i RiverCleanupAlbania: Kevin De Backer

Themeluesi dhe lideri i RiverCleanup World: Thomas de Groot

Mbështetës i lëvizjes RiverCleanupAlbania nga Rektorati i UAMD-së:
Xhafer Rakiplari

Përshtati në anglisht: Edvin Cami

Adresa:

<https://www.river-cleanup.org/en/ishem>,
<https://www.instagram.com/rivercleanupalbania/>
albania@river-cleanup.org
kevin@river-cleanup.org
thomas@river-cleanup.org

Bibliografia:

AKZM/UNDP., 2015. Marine and coastal protected areas in Albania (Zonat detare dhe bregdetare në Shqipëri), Tiranë 2015.

DIRECTIVE (EU) 2019/904. DIRECTIVE (EU) 2019/904 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 5 June 2019 on the reduction of the impact of certain plastic products on the environment. Official Journal of the European Union. L 155/1-15. 12.6.2019. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019L0904>

Galgani F, Hanke G, Werner S, Oosterbaan L, Nilsson P, Fleet D, Kinsey S, Thompson RC, van Franeker J, Vlachogianni TH, Scoullou M, Veiga JM, Palatinus A, Matiddi M, Maes T, Korpinen S, Budziak A, Leslie H, Gago J, Liebezeit G (2013). Guidance on monitoring of marine litter in European seas. Scientific and technical research series. Publications Office of the European Union, Luxembourg

González, D., Hanke, G., Tweehuysen, G., Bellert, B., Holzhauer, M., Palatinus, A., Hohenblum, P., and Oosterbaan, L. 2016. Riverine Litter Monitoring - Options and Recommendations. MSFD GES TG Marine Litter Thematic Report; JRC Technical Report; EUR 28307; doi:10.2788/461233

Gjyli L, Vlachogianni T, Kolutari J, Matta G, Metalla O, Gjyli S (2020). Marine litter on the Albanian coastline: baseline information for improved management. Ocean Coast Manage 187 (2020):105108. <https://doi.org/10.1016/j.ocecoaman.2020.105108>

<https://www.river-cleanup.org/en/ishem>,

<https://www.instagram.com/rivercleanupalbania/>

Kashta, L., 2010. Protected area gap assessment, marine biodiversity and legislation on marine protected areas Tirana - March 2010. Project “Gap Assessment of protected areas and development of marine protected areas” financed by GEF, Ministry of Environment, Forestry and Water Administration and UNDP, 38-41.

Liedermann, M.; Gmeiner, P.; Pessenlehner, S.; Haimann, M.; Hohenblum, P.; Habersack, H. A Methodology for Measuring Microplastic Transport in Large or Medium Rivers. Water 2018, 10, 414.

Miho A., Kashta L., Beqiraj S., 2013. Between the Land and the Sea - Ecoguide to discover the transitional waters of Albania. Julvin 2, Tirana. 1-462. ISBN 978-9928-137-27-2. Study of University of Tirana, 171-224.

UNEP/MAP IG.21/9. Regional Plan on Marine Litter Management in the Mediterranean in the Framework of Article 15 of the Land Based Sources Protocol. UNEP(DEPI)/ MED IG.21/9, ANNEX II – Thematic Decisions, pp.143-173.

UNEP/MAP, 2015. Marine Litter Assessment in the Mediterranean. No: 978-92-807-3564-2.



RIVER CLEANUP ALBANIA

How did it start, who are we and what do we want to reach?

Biolovealbaniangroup started in 2018 with high school volunteers, students, teachers and professors from the coastal city of Durrës, becoming part of Interreg Med ACT4LITTER Marine Litter Watch Month, a project to clean and study microplastics at the Albanian coast, referred to also as an open lecture at the University “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) on the topic: Monitoring of the marine litter on the beaches of Durrës and Lalëz bays, and finalized with a scientific article, Marine litter on the Albanian coastline: Baseline information for improved management, published in the Elsevier journal Ocean and Coastal Management.

The motivation to deal with plastic litter was the international project IPA DeFishGear (2013-2016), which was the first to study of plastic litter based on the unified methodology for all countries bordering the Adriatic Sea.

After the first experience for environmental protection, in 2019 the Biolovealbaniangroup team, as a representative of “Ibrahim Kodra” school, managed to win the second prize among 110 participating high schools in the First International Olympiad of Natural and Technological Disasters “Better Knowledge against Disasters”; an international competition organized within the BeSafeNet project, implemented by Cyprus Civil Defense / Ministry of Interior, and sponsored by the European and Mediterranean High Risk Agreement (EUR-OPA), demonstrating dignity at the Council of Europe in Strasbourg ([BeSafeNet Olympiad Award Ceremony: “Better knowledge against disasters”](#)).





Based on the success of work with young people, in 2019 they continued with cleaning and study of our coast stopping at Rodoni Bay, near St. Anthony Church, at the Cape of Rodon otherwise known as Cape of Skanderbeg.

Durrës experienced two difficult periods: the Earthquake of November 26 and Covid-19 pandemic. For this reason, this volunteers team (including high school students, students, teachers and lecturers) tried to provide its modest assistance to help people in need in Durrës region, with the collaboration of Lions Club International and Fundjavë Ndryshe.

